



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 01 nëntor 2018, në mbledhjen e VII-të (shtatë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.15’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Floretë Zejnullahu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Mirsad Kamerolli, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhje, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj rreth rendit të ditës, shtoi, nëse ndokush prej anëtarëve dëshiron të marr fjalën urdhëroni.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, kam propozim për një pikë të re shtesë në kuadër të rendit të ditës, fjala është për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i cili në fakt në mandatin e kaluar ka funksionalizuar dhe i cili është i vetmi organ ta quajmë ashtu i cili në bazë të Rregullores për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, ndër të tjera është kompetent për shqyrtimin e ankesave lidhur me ndarjen e atyre shtëpive. Themelimi i këtij Komitetit do të ishte shumë i nevojshëm ngase rast konkret kemi situatën e krijuar pas paraqitjes së një ankese nga ana e një banoreje të Lagjes në fjalë, ndaj listës së përfituesve të 20 shtëpive të përpiluar nga Komisioni përkatës i themeluar nga ky Kuvend, por që ende nuk ju janë dhuruar ato shtëpi për shkak të ankesës të cilën nuk ka pasë organ apo trup tjetër që të shqyrtoj një të tillë. Pra edhe njëherë e përsëris se do të ishte mëse e nevojshme të themelohet një Komitet i tillë përkatësisht të përfshihet në kuadër të rendit të ditës për mbledhjen e nesërme të Kuvendit, andaj edhe shpresoj se do ta keni parasysh këtë çështje dhe do ta përkrahni këtë propozim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, pra kemi një propozim konkret nga drejtori i DSHMS, Drejtori kjo e ndërlidhur me çështjet që kanë të bëjnë me gjendjen sociale, pra është kërkesë që në kuadër të rendit të ditës të përfshihet si pikë shtesë edhe kërkesa për themelimin e Komitetit në fjalë meqenëse është i

vetmi mekanizëm për shqyrtimin e ankesave në rastet e ndarjes së shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc. Unë personalisht e vlerësoj se kërkesa e tillë qenka me vend sepse tani veç jemi në prag të stinës së dimrit dhe është mëse e nevojshme që të paktën ato 20 familje të futen në shtëpi të reja, si dhe tani veç se Komisioni përkatës i Kuvendit ka bërë ndarjen e shtëpive dhe ka përzgjedh përfituesit konform Rregullores përkatëse. Komitetet e tilla janë të parapara të themelohen nga Kuvendi i Komunës, mirëpo dëshiroj t'ju njoftoj se kemi qenë në takim me MAPL-në ku temë ka qenë themelimi i komiteteve tjera, ashtu siç quhen, dhe jemi njoftuar se është në përfundim e sipër nxjerrja e një akti nënligjor me të cilin do të rregullohet definitivisht çështja e themelimit të këtyre trupave të Kuvendit ku ndër të tjera do të specifikohet edhe çështja e përbërjes së tyre, kompensimi etj, pastaj jam i informuar se para rreth 3-4 ditëve një grup punues ka qenë edhe në një punëtori në Prevallë dhe pritet që shumë shpejt të nënshkruhet ai akt nënligjor, andaj arsyeja e mos inicimit të themelimit të këtyre Komiteteve që i kemi me Statut është kjo sepse jemi duke pritur të nxjerrët ai akt dhe pastaj t'i themelojmë Komitetet e tilla të cilat sipas të gjitha gjasave anëtarët e tyre do të jenë edhe me pagesë. Prandaj sinjerisht jua them se deri tani nuk kemi pasë ndonjë situatë ku domosdoshmërisht është kërkuar të themelohen Komitetet në fjalë, mirëpo për situatën e potencuar nga drejtori i DSHMS themelimi i Komitetit në fjalë qenka domosdoshmëri, por para së gjithash secili nga anëtarët këtu mund të ketë mendime dhe ide ndryshe, andaj nëse keni diçka për të shtuar urdhëroni.

z.Avni Fetahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, e përkrahim këtë iniciativë për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Drejtori i DSHMS shumë qartë i paraqiti arsyetimet se sa është i arsyeshëm themelimi i këtij Komiteti, kështu që nuk kam diçka më shumë të shtoj rreth kësaj çështje.

z.Fitim Haziri, theksoi, edhe ashtu e pata ndërmend të ngris çështjen e këtyre Komiteteve sepse vërtetë është bërë një kohë bukur e gjatë dhe ende ne si Kuvend nuk kemi themeluar Komitetet edhe pse janë të përcaktuara me akte normative të Komunës. Në mbledhjet e para të KPF-së unë kam ngritë shqetësimin përse KPF mban mbledhje 1 ditë para mbledhjes së Kuvendit, gjë për të cilën edhe kam kërkuar përgjigje nga MAPL sipas të cilës Komuna e Podujevës nuk e ka të rregulluar këtë çështje me Statut, pastaj jam interesuar se si mbahen mbledhjet e KPF-së në Komunitat tjera, e vetmja ish Komuna e Podujevës e cila mban mbledhjet e KPF-së 1 ditë para asaj të Kuvendit, edhe pse kjo çështje nuk është e rregulluar me ndonjë ligj apo akt nënligjor. Atë që ne e kuptojmë rreth KPF-së është se ka një rol të ngjashëm me komisionet parlamentare në nivel qendrorë, ku zakonisht ne si KPF duhet paraprakisht të shqyrtojmë pikat e rendit të ditës pastaj ato t'ju dërgohen asamblistëve, praktikë të cilën e ka Mitrovica, Prishtina etj, andaj do të thoja se puna jonë si KPF do të ishte më efikase sepse kështu siç veprojmë më duket se ne vetëm vijmë në mbledhje vetëm sa për të mbajtur, mund të jem edhe gabim por mua më duket ashtu. Pra është mirë të shqyrtohet edhe kjo çështje.

Sa i përket çështjes së ngritur nga drejtori i DSHMS ne Grupi nga radhët e LVV-së jemi për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ngase vërtetë është shqetësuese fakti që janë ndarë shtëpitë në Lagjen e Dëshmorëve, përkatësisht është shpallur lista e përfituesve nga ana e Komisionit përkatës dhe për shkak të një ankese nuk po mund t'ju dhurohen përfundimisht atyre familjeve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa jam në dijeni unë nuk kemi të bëjmë me themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale por duhet të jetë Komision për shqyrtimin e ankesave për rastin në fjalë ngase Komisionin për ndarje të shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc e kemi ngritur ne si Kuvend. Pra mendoj se duhet të ngritet një Komision në përbërje të anëtarëve të Kuvendit dhe Ekzekutivit të Komunës, për shqyrtimin e ankesave, ndërsa Komitetet tjera duhet të jenë të themeluara dhe ngritën ad-hoc sipas kërkesave të Drejtorive përkatëse. Dua të them se për shqyrtimin e ankesave duhet të ngritet Komision përkatës e jo Komitet, mirëpo si do që të jetë ne e mbështesim kërkesën e drejtorit të DSHMS dhe mendojmë se paksa jemi të vonuar në këtë aspekt sa i përket ndarjes së shtëpive

në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, por për rastin konkret jemi për themelimin e një Komisioni të tillë sepse Komitetet janë të përhershme ndërsa për rastin në fjalë duhet të jetë Komisioni vetëm për shqyrtimin e asaj ankese. Pra e mbështesim ngritjen e një trupi për shqyrtimin e ankesave në fjalë, komisioni i cili duhet të jetë i paanshëm, i drejtë, i përberë nga Kuvendi dhe Ekzekutivi, në mënyrë që të zhbllloket procesi i ndarjes së shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, nga Zyra ligjore u sqarua se në vitin 2013 është nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ku ndër të tjera është paraparë edhe hartimi i një Rregulloreje nga ana e Komunës dhe përfaqësuesit të MPMS, për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc. Rregullorja është miratuar nga Kuvendi i Komunës në mandatin e kaluar dhe në të është një nen i cili parasheh që ankesat eventuale shqyrtohen nga Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Prandaj nuk shoh pengesa sa i përket kësaj çështje.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, sa për sqarim, në vitin 2014 është ngritur Komisioni për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, si dhe është themeluar edhe Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e që kam qenë pjesë e tij në cilësinë e Kryesuesit dhe kemi vepruar në bazë të Rregullores përkatëse sipas të cilët na janë dhënë autorizime për shqyrtimin e ankesave. Komiteti i cili është bartës i përgjegjësisë sa i përket ankesave të tilla, kurse Komisioni do të japë arsyetime për çka ankuesi/ja nuk është përfshirë në listën e përfituesve.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, sqarim edhe në rregulloren për ndarjen e shtëpive në fjalë, qenka e precizuar se ankesat eventuale shqyrtohen nga Komiteti në fjalë, andaj mendoj se u sqarua mjaftueshëm rreth kësaj çështje, por duhet ta themelojmë Komitetin në fjalë për arsye se është çështje urgjente shqyrtimi i asaj ankese dhe përpilimi i listës përfundimtare të përfituesve të shtëpive, nga ana e Komisionit përkatës. Andaj konsideroj se për faktin se qenka i vetmi mekanizëm për shqyrtimin e atyre ankesave besoj se jemi dakord të gjithë në këtë, mirëpo do të dëshiroja që nga kjo mbledhje të merremi vesh dhe t'i rekomandojmë Kuvendit edhe formulën e përbërjes së këtij Komiteti ku sipas Statutit duhet të jenë 7 anëtarë/e të cilët mund të jenë të gjithë nga përbërja e Kuvendit por nuk përjashtohet edhe mundësia që ndonjëri nga ata të jenë edhe nga jashtë. Do të dëshiroja që të përfshihen të gjitha subjektet dhe të ketë përfaqësim të barabartë gjinorë. Në nenin 58 i Statutit të Komunës thuhet, Komitetet tjera të përhershme nga neni 47 i Statutit, në përbërjen e tyre kanë nga 7 anëtarë, pastaj paragrafi 2 thuhet, në përbërjen e Komiteteve të cekura mund të caktohen edhe anëtarë nga shoqëria civile, por shumica e anëtarëve të tyre duhet të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës, mandej 3 thuhet anëtarësia e Komiteteve të cekura duhet të pasqyroj përpjesëtimin e numrit të ulëseve të subjekteve politike që përbëjnë Kuvendin e Komunës, dhe 4 Kuvendi i Komunës në kuadër të kompetencave miraton Rregulloren me përgjegjësi dhe fushvëprimtari të Komiteteve. Duke marr parasysh këto, unë mendoj se është mirë që përbërja e këtij Komiteti të jetë vetëm nga përbërja e Kuvendit duke përfshirë të gjitha subjektet ngase po të hyjmë në procedurën e nominimeve nga shoqëria civile konsideroj se do të vonohemi shumë në themelimin e këtij Komiteti, pra pengesa nuk kemi sepse lidhur me përbërjen ku ceken anëtarë të shoqërisë civile, në Statut thuhet, mund të jenë edhe shoqëria civile, por shumica duhet të jetë nga përbërja e Kuvendit, andaj a jeni që ta themelojmë këtë Komitet vetëm nga përbërja e Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, e mbështes që përbërja të jetë vetëm nga anëtarët e Kuvendit të Komunës ngase po të shkojmë me anëtarë edhe nga shoqëria civile atëherë do të vonohemi me themelimin e këtij Komiteti për arsye se shoqëria civile duhet të thërrasin takim, të propozojnë – nominojnë anëtarët e tyre dhe pastaj të vije në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Të gjithë anëtarët e KPF-së pajtojnë që përbërja të jetë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, rreth përbërjes kam një propozim, nëse pajtoheni a mund të shkojmë me dy anëtarë/e nga radhët e LDK-së dhe të gjitha subjektet tjera nga një anëtarë/e.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, konsideroj se është formulë e duhur kjo e propozuar nga Kryesuesi, gjithashtu mendoj se nuk është ndonjë privilegj të jesh anëtar i këtij Komiteti ngase ndër të tjerat ka të bëjë me çështje të zgjidhjeve të ankesave, andaj me rëndësi është që vendimet e Komitetit të jenë unanime dhe meritore.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, kemi të bëjmë me 20 përfitues/e të 20 shtëpive në Lagjen në fjalë, përndryshe operatori ekonomik i cili ka kryer këto punime ka një kontratë edhe për ndërtimin e shtëpive tjera, pra është një projekt i cili do të përfundoj me ndërtimin e të gjitha shtëpive për të gjitha familjet e vendosura në atë lagje përkatësisht në kontejnerët përkatës që gjenden aty, pra me rëndësi është të mos bllokohet procesi tani sepse fundja të gjitha ato familje do të jenë me shtëpi dhe do të nxjerrën nga kontejnerët në fazat e ardhshme. Unë kam qenë pjesë e këtij Komiteti në mandatin e kaluar dhe vërtetë është ndjenjë e mirë kur vendimet merren me unanimitet, por të jemi në dijeni të gjithë se nevojë kanë të gjithë për shtëpi të reja dhe pothuajse të gjitha familjet i plotësojnë kriteret për të qenë përfitues të shtëpive.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, mua personalisht më dhimbsen rreth 50 familje që janë në kushte jo të mira sociale – ekonomike, sepse të tjerat nuk qëndrojnë keq me këtë gjendje madje ka të atilla që shtëpitë mund t'i ndërtojnë edhe vet me mjete të vetat. Unë personalisht e kam vendimin për të qenë pjesë e asaj Lagjeje si i plagosur në luftë, mirëpo nuk dëshiroj të marrë shtëpi në atë Lagje gjë që më takon, por kam thënë se të gjendet një familje me gjendje jo të mirë ekonomike – sociale dhe t'i ndahet shtëpia, kushdo qoftë ajo por jo të ndahen shtëpitë personave në bazë të paragjykimeve. Prandaj konsideroj se nuk është mirë të bllokohet themelimi dhe përbërja e këtij Komiteti, madje në qoftë se LVV dëshiron dy anëtarë jam i gatshëm që të heqim dorë nga përfaqësimi jonë si Grup i PDK-së dhe t'i dërgon ajo dy përfaqësues vetëm e vetëm që të shtyhen proceset.

z.Mehmet Gashi, theksoi, e përkrahi formulën e propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit sepse përfaqësohen të gjitha subjektet dhe nuk ka dallime as me përqindje të subjekteve as të tjera, fundja Kuvendi është ai që merr vendim edhe nëse nuk arrijmë të merremi vesh sot. Në rast se ndonjë subjekt kërkon diçka më shumë, atëherë kemi edhe 4-5 Komitete tjera të cilat besoj se shumë shpejt do të themelohen dhe do të kemi parasysh, vlen të ceket se në mandatin e kaluar disa Komitete të tilla kanë qenë edhe me kryesues nga radhët e opozitës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, pra po vërej se të gjithë jemi për themelimin dhe përbërjen e propozuar por vetëm kërkoj që të kemi parasysh gjatë propozimeve të emrave edhe përfaqësimin gjinorë.

Njëzëri mbështetet kërkesa-propozimi i drejtorit të DSHMS që në kuadër të rendit të ditës, në pikën 8 të përfshihet pika shtesë:

- **Themelimi i Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,**

Njëkohësisht i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim që përbërja e Komitetit të jetë me përfaqësimin e të gjitha subjekteve, dhe atë:

(2 anëtarë/e nga radhët e LDK, 1 anëtar/e nga LVV, 1 anëtarë/e nga PDK, 1 anëtar/e nga AAK, këshilltari nga radhët e OBKD dhe këshilltari nga radhët e PD-së. Njëkohësisht rekomandohet që të merret parasysh përfaqësimi gjinor në këtë Komitet.

z.Fitim Haziri, theksoi, propozoj që pika 5 e rendit të propozuar të ditës të hiqet nga rendi i ditës, përkatësisht të shtyhet për ndonjë seancë tjetër deri sa të mendohet më shumë për ndonjë lokalitet tjetër të mundshëm.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, theksoi, po të kishim mundësi do të bënim 6 deponi të tilla sepse vërtetë nevojat janë të mëdha ngase territori i Komunës është i madh. Për këtë arsye kemi vendos që këto dy deponi të caktohen në dy pjesë në jug dhe veri për shkak që hedhja e tyre të jetë sa më e afërt për ata që hedhin materiale të tilla.

z.Fitim Haziri, theksoi, sa i përket lokacionit në fshatin Sallabajë, ne kemi vizituar atë lokalitet dhe kemi bashkëbiseduar me banorët e asaj ane. Çështja tjetër në atë pjesë kemi burim të ujit të thartë, pastaj në të kaluarën në ato vende ishte nxjerrë nikel dhe hekur, andaj tani ta zëmë atë vend me mbeturina inerte nuk e shohim të arsyeshme, do të ishte mirë që kjo pikë të shtyhej për rreth 1 muaj në mënyrë që të shikojmë bashkërisht për ndonjë lokalitet tjetër të mundshëm.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, sa jam në dijeni caktimi i lokacioneve për qëllime të tilla është çështje urgjente.

z.Fitim Haziri, pyetje, përse nuk është marrë askush më herët me një çështje të tillë, besoj se ka mundësi të gjenden lokacione tjera në ndonjë kodër apo hapësira tjera.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, theksoi, nuk di se a keni mund të gjeni dhe të shikoni lokacionet e caktuara për deponi inerte sepse në fakt në fshatin Sallabaj ajo parcelë është edhe tani deponi inerte sepse shumë mbetje të punimeve hedhen në atë parcelë – gropë, pra gjendja është faktike në atë lokacion. Ne së bashku me disa drejtor të Drejtorive përkatëse kemi vizituar shumë lokalitete me qëllim që të gjejmë lokacione për deponi inerte, kemi hasë në disa lokacione por që janë pronë nën menaxhimin e organeve dhe institucioneve tjera siç janë Agjensioni i Pyjeve të Kosovës etj, pastaj ka lokacione të cilat nuk janë të përshtatshme sepse në ato vende do të hedhen mbetjet me kamion dhe makineri të ndryshme të cilat mund të hasin në vështirësi si pasoj e terreneve. Lokacioni i propozuar në fshatin Llaushë është vendi më adekuat që mund të gjendet në territorin e Komunës ku është ajo pronë e Komunës rreth 40 ari, nga e cila kanë marrë material ndërtime etj, në të cilën tani vazhdimisht akumulohet ujë dhe është një gropë, si dhe nuk ka asnjë vendbanim aty afër, ndërsa në fshatin Sallabajë kemi një gjendje faktike ku ai lokacion shfrytëzohet për qëllime të tilla nga ana e banorëve të lokaliteteve të ndryshme.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, ta kemi të qartë se ku ka debat për çështje të tilla në këtë fazë të mbledhjes që jemi sepse ende nuk është miratuar rendi i propozuar i ditës, mirëpo edhe përkundër kësaj unë lejova që të sqarohemi sa më shumë të jetë e mundur në mënyrë që të mos kemi dilema të mëdha nesër në mbledhjen e Kuvendit.

z.Durim Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, theksoi, desha të inkuadrohem në këtë temë ngase kam qenë i angazhuar mandatin e kaluar sa isha drejtor i DPUMM. Vërtetë ne kemi bashkëpunuar shumë edhe me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kriter i parë është që prona të jetë komunale por nuk do të thotë që komuna të bënë degradim të ndonjë prone qoftë nëse është zonë urbane qoftë rurale. Sa i përket këtyre dy lokacioneve ne disa prej drejtorëve jemi angazhuar pothuajse për 10 ditë me radhë deri kemi ardhë deri te një përcaktim për dy lokacionet në fjalë të cilat i plotësojnë kushtet për deponi të mbeturinave inerte, fjala është për prona të Komunës.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne jemi në dijeni se në parcelën e propozuar në fshatin Sallabaj ka burim të ujit të thartë – mineral, mirëpo në atë parcelë supozohet se ka edhe nikel dhe hekur, andaj a keni informata ju për një gjë të tillë, sepse një student i inxhinierisë na ka thënë se në atë lokacion në të kaluarën është nxjerrë nikel dhe hekur.

z.Durim Salihu, Drejtor i DI, theksoi, sa i përket asaj që parafolësi e tha, unë nuk kam kurrfarë informacioni dhe është hera e parë që e dëgjoj një gjë të tillë.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, nëse juve ju është thënë nga një individ ashtu siç e potencove, mund të themi se ndoshta është interes i një individi, mirëpo ne si komision në nivel të drejtorëve kemi dal dhe i kemi verifikuar të gjitha pikat e mundshme dhe kemi gjet këto dy lokacione të cilat janë më të favorshme dhe përkohësisht deri sa të mbyllen – mbushen ato gropa t’i quaj ashtu, pastaj ne sigurisht që në të ardhmen do të duhet të gjejmë edhe lokacione tjera për mbeturina inerte. Për këtë propozim vendos Kuvendi nesër dhe nëse ju vendosni mund të ngritët ndonjë komision qoftë edhe në nivel të ekspertëve nëse keni dhe të mundohemi të gjejmë edhe lokacione tjera sepse janë të nevojshme edhe 2-3 lokacione të tilla.

z.Fitim Haziri, theksoi, vërejtja jonë lidhur me këtë lokacion ndërlidhet edhe me caktimin e lokacionit për impiant të ujërave të zeza në fshatin Orllan për të cilin pas një kohe keni ripropozuar tjetër lokacion me arsyetim se është gjete një burim i ujit, andaj kjo është ajo që ne e themi se mos të ngutemi me marrjen e një vendimi ku pastaj mund të ndodh ta ndryshojmë atë.

Pas votimit u konstatua se me 7 vota për, 2 vota kundër, miratohet rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë.

1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më; 04 shtator 2018 dhe 25 shtator 2018.

Njëzëri pa vërejtje miratohen:

-Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 04 shtator 2018, dhe

-Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 25 shtator 2018

2. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

- Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve - 2018

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, auditimi ka ndodh në periudhën e parë të vitit 2018 dhe fokus kryesor i auditorit ka qenë, pasqyrat vjetore financiare, menaxhimi financiar dhe kontrolli dhe rekomandimet e auditorit për vitin paraprak dhe vitet tjera, i cili në bazë të këtyre ka dhënë edhe një opinion për Komunën e Podujevës, opinion i cili është i pamodifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes është dhënë sepse ka pas mangësi në paraqitjen e pasurisë si dhe të dhëna jo të sakta tek arkëtimet, dhe në bazë të kësaj auditori ka dhënë këtë opinion si dhe janë edhe opinionet tjera të cilat janë në faqen 31 dhe 32 të raportit, ku numërohen opinion i pamodifikuar, opinion i modifikuar dhe opinion i kundërt. Gjithashtu auditori ka dhënë edhe disa rekomandime për Ekzekutivin e Komunës gjegjësisht për Komunën e Podujevë, rekomandime të cilat janë të paraqitura në planin e veprimit të përgatitur brenda periudhës prej 30 ditëve pas marrjes së këtij raporti, plan i cili i është dërguar edhe auditorit por është edhe pjesë përbërëse e këtij materiali. Pra kjo ishte vetëm një fjalë hyrëse rreth raportit, por nëse gjatë diskutimeve paraqitet nevoja për sqarime, përgjigje dhe arsyetime, unë jam i gatshëm të marrë fjalën.

z.Avni Fetahu, theksoi, ne emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e nesërme ku natyrisht se presim shqyrtimin dhe diskutime rreth shpenzimeve dhe të hyrave të Komunës për vitin përkatës fiskal.

z.Fitim Haziri, theksoi, edhe ne në emër të Grupit të LVV-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim, mirëpo ajo që më shqetëson është që përse ky raport është sjellë në maj-qershor 2018 dhe tani pas 5 muajve na sjellët për shqyrtim në Kuvend, pra meqë ka qenë i gatshëm përse është bërë kjo vonesë kur kemi parasysh se ka mund të sjellët në një rën prej dy seancave në muajin shtator në të cilat edhe ashtu nuk kanë qenë të ngarkuara shumë me pika të rendit të ditës. Prandaj është mirë që Ekzekutivi i Komunës të mos vonohet me gjëra të tilla sikurse që ishte rasti i sjelljes së peticionit dhe tani këtij raporti, por t'i sjellë me kohë pasi që veç materialin e kanë të gatshëm.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, po ashtu edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim ku natyrisht se do t'i paraqesim vërejtjet dhe sugjerimet tona.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, dëshiroj të sqaroj edhe njëherë këshilltarin z.Fitim Haziri, obligim ligjor i Komunës është që të diskutoj raportin e Auditorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Komunës brenda vitit kalendarik prej se është sjellë raporti në fjalë, tash në cilin muaj diskutohet nuk ka shumë rëndësi, andaj nuk ka kurrfarë pengesash dhe rrjedhimisht kurrfarë vonesash, andaj kur diçka kontestohet duhet të shikohet ligji se a është shkel apo jo.

Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

3. Raporti Financiar për periudhën janar – shtator 2018

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera ndër të tjera theksoi, kemi të bëjmë me një raport i cili paraqet të hyrat dhe të dalat financiare të Komunës gjatë kësaj periudhe nëntëmuajore, ku shpenzimet në total janë 12,908,637.00€ ose 55.7% e buxhetit total, kurse të hyrat paraqesin 58% e të hyrave të planifikuara për këtë vit. Tek shpenzimet kapitale kemi 28.6% të buxhetit, subvencione 38%, komunal 66.5%, shpenzime dhe mallra 42% si dhe paga dhe mëditje 72.5% të buxhetit, pra këto janë shkurtimisht shpenzimet – harxhimet e buxhetit në kategoritë e caktuara ekonomike. Sigurisht që nuk jemi të kënaqur me trendin e shpenzimeve për investime kapitale por gjithashtu nuk jemi të kënaqur as me trendin e të hyrave vetanake ku për këtë periudhë nuk është edhe aq mirë por nëse kalkulojmë deri në fund vit mund të rritet kjo përqindje e të hyrave deri në rreth 78% e planifikimeve, përqindje kjo pastaj vazhdimisht po reflekton edhe në raportet e Auditorit të përgjithshëm si dhe borxhet ndaj Komunës po grumbullohen. Pra shpenzimet tjera mund të jenë në nivelin e atyre shpenzimeve çfarë mund të jenë, por e përsëris që jemi mëse të pakënaqur me shpenzimet për investime kapitale, mirëpo shpresoj që në këtë periudhë të mirë kohore-klimatike që është duke ndodh, të ndikoj në kryerjen e punëve më shpejt, ku shumica prej tyre janë në përfundim e sipër dhe shpresojmë që të paktën deri në fund të vitit fiskal, shpenzimet për këtë kategori t'i afrohen 90%.

z.Avni Fetahu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim ku nesër presim të zhvillohen diskutime rreth këtij raporti.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, drejtori e tha se raporti paraqet një pasqyrë financiare për të hyrat dhe të dalat e Komunës, andaj shqyrtimi i të njëjtit në Kuvendi i shërben transparencës së Ekzekutivit të Komunës ndaj Kuvendit të Komunës. Gjithashtu drejtori në fjalën hyrëse ngriti tonet dhe shqetësimet lidhur me këtë raport andaj ne mund ti bashkohemi atyre në mënyrë që të kemi një shpenzim sa më të mirë të parasë publike, mirëpo raportin si të tillë e çmojmë si transparencë të Ekzekutivit në raport me Kuvendin e Komunës sa i përket shpenzimit të parasë.

znj.Adelina Stublla, theksoi, të gjithat vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i paraqesim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtimin e raportit në fjalë, edhe pse raporte të tilla nuk i nënshtrohen votimit por ne si Kuvend duhet të dalim dhe të japim opinionet tona.

Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

4. Propozim vendimi për dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, kemi të bëjmë me kërkesat e KEDS që janë paraqitur gjatë kësaj periudhe 2 mujore me të cilat janë kërkuar 5 lokacione për ndërtimin e trafostacioneve dhe vendosje të shtyllave në lokacione dhe zona të ndryshme sipas propozim vendimit dhe materialit përkatës. Pra për hir të përmirësimit të furnizimit me energji elektrike për qytetarët është propozuar të jepen në shfrytëzim afatshkurtër dhe pa pagesë pjesët e parcelave përkatëse.

z.Avni Fetahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratimin e këtij propozim vendimi.

z.Fitim Haziri, theksoi, dëshiroj të pyes, a keni provuar ndonjëherë që pronat e tilla të jepen me pagesë KEDS-it, qoftë edhe 1 € në muaj.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, përgjigje parafolësit, po ne kemi tentuar dhe kemi marr vendim madje për një gjë të tillë, mirëpo na është dashtë ta rishqyrtojmë atë vendim për shkak se KEDS nuk ka pranuar që pjesët e pronave për këtë qëllim të jepen me pagesë dhe si rrjedhojë pastaj do të ndaloheshin edhe investimet e KEDS në territorin e Komunës së Podujevës, që nuk janë të pakta. Dhe këtë mund t'jua dëshmoj edhe me dokumentacion kurdo që shprehni dëshirë. Vlen të ceket se këtë praktikë të dhënies së pronave në shfrytëzim KEDS-it e ndjekin të gjitha Komunat e Kosovës, gjë të cilën mund ta vërtetoni secili prej juve përmes ueb faqeve zyrtare të Komunave.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, sa për njoftim KEDS për këtë vit ka 7.8 milion euro investime në territorin e Komunës së Podujevës, investim që është bërë falë bashkëpunimit dhe komunikimit shumë të mirë që kemi, kurse për vitin 2019 ka të planifikuara 5.6 milion euro për investime në Komunën e Podujevës, ndërsa ne shpresojmë që deri në vitin 2021 ta përmbyllim komplet rrjetin e infrastrukturës energjetike nga ana e KEDS. Vlen të ceket se ka Komuna në të cilat KEDS as përafërsisht nuk ka ndarë dhe investuar, por falë bashkëpunimit mes Komunës dhe kësaj Kompanie është arritur një investim i tillë në territorin e Komunës së Podujevës, falënderimet janë të dyanshme.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, vazhdimisht propozime të tilla ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së i kemi përkrahur dhe vazhdojmë t'i përkrahim sepse investimet e KEDS duhet të ndodhin. Sa i përket kompensimit unë personalisht kam kërkuar që pronat e tilla t'i jepen KEDS-it qoftë edhe me 0.5 € për m² shumë kjo e cila vetëm të figuroj si pagesë që i bëhet Komunës, është marrë vendimi mirëpo i njëjti është kthyer negativ dhe na është dashtë të heqim atë pagesë të paraparë. Ne mund të mos miratojmë propozime të tilla por mendoj se nuk është mirë sepse të gjithë jemi në dijeni se rrjeti i furnizimit me energji elektrike është i vjetruar dhe nuk është i mirë, andaj me faktin që jemi në poste të miratojmë ose mos miratojmë nuk është mirë të shfrytëzojmë këtë pozitë për qëllime të ndryshme sepse pastaj dëmtojmë qytetarët tanë. Unë personalisht do të dëshiroja që kjo Kompani të ishte shtetërore ose të ishte përëndimore por tani kemi këtë që kemi dhe duhet të pajtohemi, mirëpo e rëndësishme është që pronat mbeten komunale – shtetërore dhe të njëjtat nuk mund të shfrytëzohen ose përdoren për ndonjë çështje tjetër. Prandaj duke u mbështetur në këto, ne i përkrahim këto propozim vendime, përndryshe ne jemi për inkasime nga Komuna, por në këtë rast këtë mundësi nuk e kemi.

Pas votimit u konstatua se me 7 vota për, 2 vota kundër, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim

5. Propozim vendim për caktimin e lokacionit me destinim për deponimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbeturinave të krijuara nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore

z.Fatmir Gashi, Kryesues, nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën, urdhëroni, nëse jo e hedh në votim, kush është që kjo pikë t'i rekomandohet Kuvendit.

Pas votimit u konstatua se me 7 vota për, 2 vota kundër, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim

6. Propozim vendimi për shpallje interes publik (ndërtimi i rrugë përgjatë brezit të lumit Llap në Qytet)

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, dëshiroj t'ju njoftoj se rruga e re e cila është duke u ndërtuar në anën e kundërt të lumit Llap, nga rreth rrotullimi në drejtim të Xhamisë duke vazhduar tutje dhe lidhet me rrugën "Vëllëzërit Frashëri", me Planin Urban dhe Planin Zhvillimor Komunal është e paraparë vetëm njëra pjesë e rrugës kështu që ne si Drejtori nuk kemi pasë mundësi që të zhvillojmë procedurat e shpronësimit për pjesët e pronave private, apo hapat tjerë në bazë të ligjit që mund t'i bëjmë bashkërisht me qytetarët, kështu që edhe pse projekti në fjalë është në fazën përfundimtare jemi të detyruar që fillimisht të shpallim në interes publik pronat të cilat preken nga realizimi i projektit, dhe jam shumë falënderues ndaj banorëve të asaj zone me të cilët kemi komunikuar jashtëzakonisht mirë pavarësisht që ndonjëherë mund të kemi pasë mospajtime. Projekti është në fazën përfundimtare mirëpo për të qenë transparent para qytetarëve në veçanti atyre që ju merren pjesë të pronave të tyre ne kemi qenë të detyruar që ato pjesë të pronave t'i propozojmë në Kuvend me qëllim të shpalljes së tyre interes i përgjithshëm publik, dhe ftoj të miratoni një propozim të tillë në mënyrë që të fillojmë me procedurat tjera të shpronësimit në funksion të realizimit të projektit.

z.Avni Fetahu, theksoi, sigurisht që ndoshta në mbledhjen e Kuvendit kemi nevojë për informata shtesë lidhur me këtë propozim vendim, si ndikon ky projekt tek qytetarët, shpenzimet e mundshme dhe gjithçka tjetër në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë dhe në këtë kontekst natyrisht që jemi që ti rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, njoftim shtesë, vonesa që ka ndodh është për shkak se pronat kanë qenë të bartura por kanë qenë të gjyshërve apo katragjyshërve të tyre dhe nuk kanë mund t'i përkthejnë deri tani, por përkthimet janë bërë në fund të muajit tetor të këtij viti dhe ne si Drejtori menjëherë kemi hartuar dhe proceduar në Kuvend këtë propozim vendim të cilin e keni paravetës. Pra më herët nuk kemi pasë mundësi sepse kanë qenë shumë pronarë, madje edhe tani pas përkthimeve janë shumë pronarë të atyre pronave siç mund t'i shihni edhe në material, gjë për të cilin sigurisht jemi në dijeni të gjithë se si kanë qenë pronat në kohërat e mëhershme, por që tani secili e ka ndarë pjesën e vet dhe secili e dinë saktë se sa pronë i merret për ndërtimin e rrugës.

z.Fitim Haziri, theksoi, dëshiroj një sqarim nga drejtori parafolës, a i'u është marr prona atyre pronarëve para se të bëhet shpronësimi.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, ka qenë një marrëveshje verbale mes Komunës dhe pronarëve të pronave përkatëse.

z.Fitim Haziri, theksoi, sipas kësaj po del që nuk janë përfill procedurat e parapara ligjore.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, përgjigje parafolësit, në bazë të ligjit, procedurat e shpronësimit mund të marrin kohë deri në dy vite. Punimet janë bërë në një pjesë të pronave që do t'i nënshtrohen shpronësimit por pjesa më e madhe është pronë komunale, pra janë vetëm afër 50 ari pronë private që preken nga ky projekt. Kemi mundësi që të bëjmë tri marrëveshje – variante: automatikisht të shkojmë me shpronësim nëse qytetarët janë të interesuar, mund të shkojmë me këmbim të pronave që bëhet përmes vlerësimit të pronave dhe mundësia tjetër është dhënia e lejeve në ndërtim ku sipas kësaj nëse një pronar ta zëmë ka 2 ari për shpronësim, ata 2 ari përfshihen në ndërtim dhe nuk bënë pagesa fare. Për mendimin tim varianti më i mirë është ky i fundit ku përmes kësaj jepet leja në ndërtim, andaj mu për këtë arsye nuk është bërë shpronësimi më herët variant për të cilin as vet qytetarët nuk kanë qenë të interesuar. Pastaj kemi dy objekte për të cilat duhet të bëjmë shpronësim ku njëra prej tyre ka një pjesë e cila është ndërtim në pronë komunale e që njëherë përnjëherë nuk mund ta rrënoj pa bërë paraprakisht një vlerësim dhe të shikohet se si të trajtohet sipas ligjit. Shpronësimi bëhet nga Departamenti i shpronësimit në Ministrinë e Financave ku është komisioni i veçantë për vlerësime të pronave dhe pastaj edhe shpronësimet e tyre.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së jemi që t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim, mirëpo vetëm edhe një gjë desha të sqarohem, pjesa e cila prek pronën e Bashkësisë Islame përkatësisht tek Xhamia, a mund ta shohim se ku gjendet ajo pjesë sepse sa kam parë unë janë mbi 1000 m² që i merret, ndoshta mund të jem edhe gabim.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, nuk shoh se Këshillit të Bashkësisë Islame i merren ajo pjesë që parafolësi e ceku, por në propozim vendim është qartë se Bashkësisë islame i merren vetëm rreth 24 m².

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne në emër të Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, i rekomandojmë Kuvendit që ta shqyrtoj këtë pikë.

Pas votimi u konstatua se njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim

7. Propozim vendimi për ridestinimin e objektit "Pushimorja për fëmijët bonjak" në fshatin Orllan

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, edhe pse kjo fushë bie në fushveprimtarinë e Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, me leje të Drejtorit përkatës dëshiroj që paraprakisht të jap disa sqarime dhe arsyetime rreth kësaj pike. Objekti në fjalë është ndërtuar në vitin 2004 dhe i cili në atë kohë është menduar të jetë i destinuar për fëmijët bonjak të cilët kanë humbur familjarët e tyre në luftë, mirëpo siç dihet Kosova mori trendin e shpejtë të zhvillimit dhe disa prej akterëve filluan të mendojnë që ai objekt të mos funksionalizohen për një çështje të tillë për të cilën pastaj rrjedhën e çështje tjera sepse atë objekt kërkohet ta merrte në menaxhim dhe administrim ndonjë institucion për shkak të rëndësisë dhe kostos së madhe që mund të kishte. Objekti ka 17 dhoma banimi, 2 salla të mëdha të konferencave etj, andaj shkaku që ai objekt ka mbet i pafunksionalizuar ne kemi menduar që të njëjtit t'ia ndërrojmë destinimin për qëllime të ndryshme, shembull, të gjitha konferencat, trajnimet dhe punëtoritë e ndryshme që bëjnë Komunitat dhe institucionet tjera për të cilat shkojnë në vende të ndryshme të Shqipërisë, ato do të mund t'i mbajnë në fshatin Orllan në atë objekt i cili ofron edhe mundësi fjetje për 64 persona. Pastaj kemi menduar edhe destinime tjera në mënyrë që

Komuna të mund të inkasoj të hyra nga ai objekt. Krejt çka është e nevojshme të investohet është kuzhina.

z.Fitim Haziri, pyetje parafolësit, në pronësi dhe menaxhim të kujt është ai objekt.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, përgjigje parafolësit, prona dhe objekti janë në pronësi të Komunës kështu që sa i përket këtij aspekti nuk paraqiten kurrfarë pengesash , ndërsa sa i përket menaxhimit do të shikojmë se si do të veprojmë sepse kemi të bëjmë edhe me kuzhinën-ushqimore, por sigurisht që do të bëhet një plan i menaxhimit.

z.Avni Fetahu, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi sigurisht që do të ishte mirë të kishte një projekt më të detajuar i cili do t'i prezantohej Kuvendit të Komunës në mënyrë që të njoftohemi me benefitet dhe shpenzimet që do t'i ndodheshin Komunës dhe që do të krijonte një ambient më të mirë tek këshilltarët e Kuvendit për ta votuar këtë propozim vendim. Pra është mirë të definohet mirë çdo çështje duke marrë parasysh se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë është duke marrë aksione të ndryshme për rrënimin e shumë objekteve dhe hapësirave në atë zonë pranë liqenit. Në të njëjtën kohë duhet të analizohet edhe çështja e trajtimit të ujërave të zeza.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket ujërave të zeza, objekti në fjalë ka të rregulluar sistem të veçantët të izoluar të ujërave të zeza, po ashtu e ka sistemin e veçantë edhe të ujit përmes rezervuarve

z.Avni Fetahu, theksoi, e nevojshme është që të mos krijohen pakënaqësi ose parregullsi në raport me Ministrinë përkatëse, përndryshe mendoj se ndoshta është një humbje kohe që ai objekt ka qëndruar aq gjatë pa u shfrytëzuar dhe natyrisht ne jemi për një gjë të tillë dhe i rekomandojmë Kuvendit këtë propozim vendim njëkohësisht gjetjen e një zgjidhjeje dhe mundësive për funksionalizimin e atij objekti.

z.Fitim Haziri, theksoi, është e vërtetë që ai objekt qëndron për një kohë të gjatë ashtu siç është edhe sot, ne kemi vizituar atë objekt dhe vërtetë është objekt fantastik dhe në një vend fantastik, por është gjynah që ai objekt qëndron i pa funksionalizuar qe 14 vite dhe për një gjë të tillë duhet të merr përgjegjësi dikush. Ne jemi që ai objekt të jetë ndërmarrje publike komunale, mirëpo si do që të jetë i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim duke shpresuar funksionalizimin sa më shpejt të tij.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne vërtetë kemi para vetës një propozim vendim për ridestinimin e objektit, dhe këtë mund të bëjmë duke shfuqizuar një vendim të mëparshëm, por natyrisht duhet të ketë edhe arsyetim nga ana e Ekzekutivit të Komunës sepse ka një vendim për çka është ndërtuar ai objekt dhe tani duhet të ketë një arsyetim për çka po ndërrohet destinimi. Pastaj se si do të shfrytëzohet ai objekt dhe a do të jepet në shfrytëzim duhet të ketë edhe një vendim tjetër, andaj mendoj se në seancën e nesërme do të diskutohet vetëm ndërrimin e destinimit të objekti. Jam që ai objekt të mos mbetet i pa shfrytëzuar ashtu siç është, për çka ka qenë i destinuar nuk është shfrytëzuar asnjëherë. E mbështesë që ky propozim të shqyrtohet në mbledhjen e Kuvendit mirëpo nesër në mbledhjen e Kuvendit do të paraqesë më gjerësisht pozicionin tim sepse mendoj se do ta kemi problem edhe ta ruajmë atë objekt, fizikisht është fjala dhe nuk besoj se do të arrij të funksionalizohet ndonjëherë, mirëpo si do që të jetë jam për ndërrimin e destinimit dhe inkasimit të të hyrave nga ana e Komunës duke mos përjashtuar edhe konsultimin me ligjet në fuqi sa i përket atyre familjeve për çka ka qenë i destinuar objekti në fjalë. Kur e thash që do të kemi problem ta mbrojmë fizikisht atë objekt e ndërlidha me atë se zona e Orllanit është shumë e komplikuar për çka mendoj se Ekzekutivi i Komunës nuk është i njoftuar në tërësi për një gjë të tillë përkatësisht për gjendjen që është në fshatin Orllan sa i përket pronave në atë zonë, tani kemi edhe fazën e dytë të rrënimeve që do të filloj nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, pastaj kemi edhe planin strategjik të BE-së dhe rreth 30 milion euro që do të investohet në liqenin e Batllavës në ngritjen e pendës, gjëra të cilat nesër në seancë do t'i paraqesë, mirëpo për objektin në fjalë jam për, që të bëhet ridestinimi në mënyrë që të shfrytëzohet ashtu siç është. Arsyetimi është dhënë se fëmijët për të cilët ka qenë i destinuar ai objekt tani ata janë rritë dhe kanë mbi 18 vite, mirëpo nuk kanë

marrë asnjë të mirë nga kjo Komunë, madje nuk di se a janë identifikuar të gjithë fëmijët bonjak nga lufta e fundit, e lëre më të flasim diçka për t'iu ndihmuar atyre, qoftë në aspektin financiar qoftë në aspektin e mbrojtjes dhe strehimit dhe në këtë aspekt jam i sigurt se po të publikohen listat e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, del që marrin pension social njerëzit që nuk e meritojnë, nëse drejtori është i gatshëm t'i publikoj emrat bashkërisht me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, temë tjetër kjo por që nuk dua të zgjati më shumë, mirëpo sa i përket temës në fjalë unë shumë jam i bindur se Komuna do ta ketë të vështirë edhe ta ruaj konstruktin fizik të atij objekti, kurse e mbështes që t'i ridestinohet qëllimi objektit në fjalë. Unë jam në dijeni se është bërë edhe tjetërsim i pronave në mënyrë të paligjshme në atë zonë, por si do që të jetë unë nesër do të japim qëndrimin dhe sqarime, informatat dhe gjëra tjera. Jam në dijeni se nesër do t'i japim mbështetje ridestinitimit të atij objekti mirëpo normal duhet të kemi një arsyetim ashtu siç e ceku këshilltari z.Avni Fetahu, sepse jemi në dijeni se po e shfuqizojmë një vendim të mëparshëm i cila ka qenë donacion i UFORK-ut në participim edhe me Komunën në atë kohë për një qëllim të caktuar.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, dëshiroj të plotësoj paksa parafolësit, ne si Drejtori këtë propozim vendim e kemi mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2016-2018. Unë sot pata takim me disa gazetar rreth një kundërshtimi që është bërë rreth këtij propozim vendimi nga ana e një OJQ-je të fshatit Orllan, pastaj mund t'ju njoftoj se edhe më parë kemi pasë kundërshtime në mandatet e kaluara të Kuvendit me rastin kur kemi bërë njoftimin për dhënie në shfrytëzim objektin në fjalë për qëllimin që aktualisht e ka sepse sa për njoftim këtë paluajtshmëri Kuvendi i Komunës përkatësisht Komisioni përkatës 2 herë e ka shpall për dhënie në shfrytëzim, çmimi fillestar ka qenë 3 € për m² dhe nuk ka pasë asnjë ofertues, ngase sipas mendimit tim kur nuk ka asnjë donacion për ata fëmijë askush nuk dëshiron të marrë një barrë të tillë andaj as Komuna nuk ka mund të marrë një barrë të tillë të menaxhoj me atë objekt. Sa i përket asaj se si Ministria dhe UFORK në atë kohë e ka bartë në pronësi të Komunës nuk po hymë andej sepse nuk është e rëndësishme, mirëpo tani për të mos lënë ende ashtu në një gjendje të tillë kemi propozuar ridestinitimin e atij objekti duke pas pikë mbështetjeje Stërgjinë e lartë cekur, por edhe duke marrë për bazë se ajo zonë nuk është e zhvilluar sa duhet, andaj ne kemi menduar t'ja ndërrojmë destinimin dhe ta japim në shfrytëzim me qëllim të zhvillimit të asaj zone përmes turizmit e që rrjedhimisht do të zhvillohej edhe blegtoia dhe fusha tjera. Unë mendoj se është shumë e qëlluar ideja e ndërrimit të ridestinitimit duke marrë parasysh se nga viti 2010 është vendimi për dhënie në shfrytëzim dhe asnjëherë nuk ka pasur të interesuar për atë objekt me një destinim të tillë që aktualisht e ka. Në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2016-2018 pika 5.3 nën-pika 1.17 e pikës 1.4 parashihet ridestinitimi i këtij objekti sepse destinimi aktual paraqet pengesë për dhënie në shfrytëzim të atij objekti ngase 2 herë ka dal për dhënie në shfrytëzim dhe nuk ka pas asnjë të interesuar, ndërsa në anë tjetër Komuna ka shpenzime të ndryshme për atë objekt (rrymë, roje, ujë etj), prandaj mendoj se më mirë është të jepet në shfrytëzim dhe të përfitoj Komuna, të ketë punësime etj, ndërsa në qoftë se ne vendosim të bëjmë Shoqëri Aksionare nuk e besoj se do të mund ta menaxhojmë, por si do që të jetë ashtu siç e parasheh Kuvendi ne do të veprojmë.

Pas votimi u konstatua se njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim

8. Themelimi i Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim që përbërja e Komitetit të jetë me përfaqësimin e të gjitha subjekteve, dhe atë:

(2 anëtarë/e nga radhët e LDK, 1 anëtar/e nga LVV, 1 anëtarë/e nga PDK, 1 anëtar/e nga AAK, këshilltari nga radhët e OBKD dhe këshilltari nga radhët e PD-së. Njëkohësisht rekomandohet që të merret parasysh përfaqësimi gjinor në këtë Komitet.

Kosntatim shtesë:

Para përfundimit të kësaj mbledhjeje nga anëtari z.Avni Fetahu, u ngritë edhe çështja e organizimit të një vizite në Shqipëri për nderë të 28 Nëntorit, por duke pas edhe qëllim të gjetjeve të mundësive për bashkëpunim dhe për qëllim të hartimit të draft – planit të punës së Kuvendit për vitin 2019, çështje për të cilën u pajtuan të gjithë këshilltarët që kjo çështje të diskutohet edhe në Kuvend, në pikën të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0086946/18

Podujevë,

02 nëntor 2018

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi